



PROPOZIM

Në bazë të nenit 48, paragrafit (1), pikës 3) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe në lidhje me pikën 7) të Vendimit për Përcaktimin e Listës së Shërbimeve më Përfaqësuese në Lidhje me Llogarinë Pagesore dhe Formën dhe Përmbajtjen e Dokumentit Informativ për Tarifat dhe Raportin për Tarifat dhe Simbolet e tyre të Përbashkëta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 271/22), guvernatorja e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

UDHËZIM

për mënyrën e hartimit të dokumentit informativ për tarifa, fjalorit dhe raportit të tarifave

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë udhëzim përshkruhen:
 - mënyra e hartimit dhe standardet teknike të cilat ofruesit e shërbimeve pagesore i zbatojnë gjatë hartimit të dokumentit informativ për tarifa dhe fjalorin;
 - mënyra e hartimit dhe standardet teknike të cilat ofruesit e shërbimeve pagesore i zbatojnë gjatë hartimit të raportit informativ për tarifave;
2. Gjatë hartimit të dokumentit informativ, fjalorit dhe raportit mbi tarifave, ofruesit e shërbimeve pagesore, janë të obliguar t'i përdorin termet dhe definicionet e shërbimeve më përfaqësuese të shënuara në pikën 4) nga Vendimi për Përcaktimin e Listës së Shërbimeve më Përfaqësuese në Lidhje me Llogarinë Pagesore dhe Formën dhe Përmbajtjen e Dokumentit Informativ për Tarifa dhe Raportin e Tarifave dhe Simbolet e tyre të Përbashkëta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 271/22, në tekstin e mëposhtëm: Vendimi).

II. DOKUMENT INFORMATIV PËR TARIFAT

3. Ofruesit e shërbimeve pagesore, janë të obliguar t'i japin konsumatorit dokument informativ për tarifave për të gjitha shërbimet, që gjinden në listën e shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me llogarinë pagesore, në letër ose në tjetër bartës të përherëshëm të të dhënave.

4. Ofruesit e shërbimeve pagesore, janë të obliguar t'i japin konsumatorit "Dokument informativ për tarifat" i përcaktuar në Shtojcën 1 nga Vendimi (në tekstin e mëposhtëm: formulari DIT ose DIT-në), për çdo llogari pagesore veçmas.
5. Ofruesit e shërbimeve pagesore, janë të obliguar ta përdorin formularin DIT dhe ta plotësojnë duke iu përmbajtur përmbajtjes, formës, simbolit, madhësisë dhe stilit të fontit, ngjyrës, ndarjes dhe shtrirjes së tekstit siç është përshkruar me këtë udhëzim njëkohësisht duke e respektuar renditjen e informacioneve, titullin dhe nëntitullin e kolonave të përcaktuara në formularin DIT. Ky formular duhet:
 - të shfaqet në formatin A4, me orientim vertikal;
 - të shkruhet në ngjyrë të bardhë dhe të zezë;
 - logoja e ofruesit të shërbimit pagesor dhe simboli i përbashkët, mund të shfaqen me ngjyra, ku logoja e ofruesit të shërbimit pagesor mund të jetë me ngjyra, vetëm nëse simboli i përbashkët është me ngjyrë. Nëse është bardhezi, simboli i përbashkët duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm. Nëse simboli i përbashkët është me ngjyra, përdoret shembull me ngjyrë me numër referues 0/51/153 (hyrje heksadecimale: 003399), model i ngjyrës për bazë dhe shembull ngjyra 255/204/0 (hyrje heksadecimale: FFCC00) me model të ngjyrës RGB për simbol. Logoja e ofruesit të shërbimeve pagesore është në madhësinë e njëjtë, sikur simboli i përbashkët;
 - përmban titullin "Dokument informativ për tarifat" në krye të faqes së parë, i cili është i vendosur në qendër dhe është mes logos së ofruesit të shërbimeve pagesore në këndin e sipërm të majtë të dokumentit dhe simbolit të përbashkët në këndin e djathtë të sipërm të dokumentit;
 - përmban titull të kolonave në ngjyrë gri gjysmë të errët, duke përdorur shembull të ngjyrës me numër referues 166, 166, 166 në model të ngjyrave RGB dhe nëntitujt në kolonat me ngjyrë gri të hapur, duke përdorur shembull të ngjyrës me numër referues 191, 191, 191 me model të ngjyrave RGB;
 - është në stilin e shkronjave Arial ose tjetër të ngjashëm me Arial, madhësia e shkronjave 11, përveç titullit "**Dokument informativ i tarifave**", i cili duhet të printohet me shkronja të zeza me madhësi 16, titujt e kolonave me shkronja të zeza me madhësi 14, si dhe nëntitujt të kolonave të cilat duhet të printohen me shkronja të zeza me madhësi 12, përveç nëse zmadhimi i shkronjave ose përdorimi i alfabetit Brajt, për personat me shikim të dëmtuar është dakorduar ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve pagesore;
 - përmban simbole të përbashkëta me dimensione 2,5 x 2,5 cm, të shfaqura në pajtim me simbolin e pozicionuar në këndin e sipërm të djathtë, në formularin DIT;
 - tarifat në DIT shfaqen në denarë, ndërsa në valutë tjetër vetëm për jo rezidentë dhe nëse e njëjta, është dakorduar mes ofruesit të shërbimeve pagesore dhe konsumatorit;
 - faqet janë të numëruara.
6. Gjatë hartimit të DIT ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar për shërbime individuale më përfaqësuese nga lista e shërbimeve më përfaqësuese, që kanë të bëjnë me llogarinë pagesore të konsumatorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut të përcaktuara me pikën e 4) nga Vendimi ti përfshijnë vetëm këto tarifa:

6.1. Mirëmbajtja e llogarisë

Shërbimi **mirëmbajtja e llogarisë** përfshin tarifa mujore për mirëmbajtje të llogarisë. Tarifa e këtij shërbimi nuk përfshin tarifën për lëshim të kartelës debitore, as tarifën për hapje dhe mbyllje të llogarisë pagesore.

6.2. Përdorimi i shërbimeve onlajn që lidhen me llogari pagesore

Shërbimi **përdorimi i shërbimeve onlajn që lidhen me llogari pagesore**, përfshin tarifa mujore të anëtarësimit për përdorim të shërbimeve nëpërmjet rrjetit komunikues të disponueshëm publik, siç është interneti dhe/ose aplikacioni celular. Tarifa për këtë shërbim nuk përfshin tarifën për prezantimin ose marrëveshje për shërbimin dhe tarifën për softuerin ose harduerin për realizimin e aktiviteteve konkrete gjatë përdorimit onlajn të shërbimeve të lidhura me llogarinë pagesore (për shembull: token ose pajisje të ngjashme).

6.3. Transferta e kredisë në denarë në vend

Shërbimi **transferta e kredisë në denarë në vend** përfshin tarifën për transfertat e kredisë pa para të gatshme në vend të cilat shfaqen në varësi nga kanali për inicim të transaksionit (për shembull nëpërmjet internetit dhe/ose ndonjë aplikacioni celular), varësisht nga pranuesi i pagesës (për shembull në dobi të personit fizik ose juridik të ofruesit i njëjtë i shërbimeve pagesore ose në dobi të llogarisë të një ofrues tjetër të shërbimeve pagesore).

6.4. Transferta e kredisë në euro jashtë vendit

Shërbimi **transferta e kredisë në euro jashtë vendit** përfshin tarifën për transfertat e kredisë pa para të gatshme në euro jashtë vendit të cilat shfaqen varësisht nga kanali i inicimit të transaksionit (për shembull nëpërmjet internetit dhe/ose ndonjë aplikacioni celular) dhe varësisht nga fakti nëse tarifa paguhet nga paguesi dhe/ose pranuesi.

6.5. Transferta e kredisë në valutë të ndryshme nga euroja jashtë vendit

Shërbimi **transferta e kredisë në valutë të ndryshme nga euroja jashtë vendit** përfshin tarifën për transfertat pa para të gatshme në valutë të ndryshme nga euroja jashtë vendit të cilat shfaqen varësisht nga kanali i inicimit të transaksionit (për shembull nëpërmjet internetit dhe/ose ndonjë aplikacioni celular) si dhe varësisht nga elementi i shpenzimit.

6.6. Të hyra nga jashtë

Shërbimi **të hyra nga jashtë** përfshin tarifë e cila i paguhet konsumatorit gjatë hyrjes së mjeteve monetare me transfertat të kredisë nga jashtë vendit në llogarinë pagesore të konsumatorit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

6.7. Urdhëresë e përhershme

Shërbimi **urdhëresë e përhershme** përfshin tarifa për marrëveshjen e urdhëresës së përhershme për kryerje të transaksionit në bazë të urdhëresës së përhershme dhe të cilat shfaqen në varësi nga llogaria pagesore në dobi të së cilit procedohet (për shembull llogari pagesore te ofruesi i shërbimeve pagesore ose te një tjetër ofrues të shërbimeve pagesore në vend).

6.8. Emetimi i kartelës debitoare

Shërbimi **emetimi i kartelës debitoare** përfshin tarifa për regjistrim dhe tarifa mujore (vjetore) për anëtarësim për kartelën më të pranueshme debitorë, të cilën ofruesi i shërbimeve pagesore e mban llogarinë pagesore zakonisht ua lëshon konsumatorëve.

6.9. Emetimi i kartelës kreditore

Shërbimi **emetimi i kartelës kreditore** përfshin tarifa për regjistrim dhe tarifa mujore (vjetore) për anëtarësim për kartelën më të pranueshme kreditore, të cilën ofruesi i shërbimeve pagesore e mban llogarinë pagesore zakonisht ua lëshon konsumatorëve.

6.10. Tërheqje e parave të gatshme

Shërbimi **tërheqje e parave të gatshme** përfshin tarifa për tërheqje të parave të gatshme pa kartelë pagesore në sportel tek ofruesi i shërbimeve pagesore dhe me kartelë debitoare ose kreditore në bankomat dhe shënohen në varësi nga ajo se a bëhet fjalë për kartelë debitoare dhe/ose kreditore, varësisht nga ajo se a bëhet fjalë për bankomat ofrues i shërbimeve pagesore që ka lëshuar kartelën ose ndonjë bankomat tjetër në vend ose jashtë vendit. Me këtë shërbim nuk është përfshirë tërheqja e parave të gatshme me kartelë pagesore në bankomat me këste.

6.11. Mbitërheqja e lejuar

Shërbimi **mbitërheqja e lejuar** si tarifë përfshin normën nominale vjetore të interesit të mbitërheqjes së lejuar.

III. MËNYRA DHE STANDARDET TEKNIKE PËR PLOTËSIMIN E DIT

7. Ofruesit e shërbimeve pagesore i përmbahen mënyrës dhe standardeve teknike të plotësimit të pjesëve të caktuara nga DIT-i të përcaktuara me këtë kapitull.

7.1 Emri i ofruesit të shërbimeve pagesore

Shënohet emri i ofruesit të shërbimeve pagesore i cili e mban llogarinë pagesore të konsumatorit dhe i cili e lëshon DIT-i. Emri duhet të shkruhet me një font të theksuar dhe të rreshtohet nga e majta.

7.2. Emri i llogarisë pagesore

7.2.1. Ofruesit e shërbimeve pagesore hartojnë DIT-në të caktuar për çdo lloj të llogarisë pagesore (për shembull llogari pagesore në denarë, llogari pagesore në euro) dhe/ose kategori të konsumatorëve (për shembull punonjës, pensionistë, studentë, kategori të ndjeshme sociale të

konsumatorëve në pajtim me ligjin dhe të ngjashme) dhe në pajtim me të njëjtën e përcaktojnë emrin e llogarisë në DIT.

- 7.2.2. Nëse tarifat në DIT-në dallohen **vetëm** për shërbimin **mirëmbajtje të llogarisë dhe/ose për mbitërheqje të lejuar** dhe tarifat për të gjitha shërbimet tjera janë të barabarta, ofruesi i shërbimeve pagesore mund të lëshojë DIT vetëm për më shumë lloje të llogarive dhe për më shumë kategori të konsumatorëve.
- 7.2.3. Ofruesi i shërbimeve pagesore i cili bën marrëveshje për tarifa me një konsumator të caktuar (për shembull: *Student*), nuk është i obliguar të lëshojë DIT. Por nëse ka një grup të konsumatorëve, të cilëve sipas kriterëve të përcaktuara paraprakisht, u jepet oferta e njëjtë, në atë rast ofruesit e shërbimeve pagesore është e nevojshme të hartojnë DIT të posaçëm për çdo konsumator të caktuar.
- 7.2.4. Në rast se ofruesi i shërbimeve pagesore ofron llogari pagesore **në paketë me shërbime tjera** të lidhura me llogarinë pagesore, mënyra e hartimit të DIT dhe përmbajtja janë të përshkruara në pikën 11) të këtij kapitulli.
- 7.2.5. Për qëllimet e aksioneve të përkohshme të cilat vlejnë vetëm një periudhë të shkurtë kohore (për shembull periudhë e aksioneve të vitit të ri nga dd.mm.vvvv deri dd.mm.vvvv), ofruesi i shërbimeve pagesore nuk është i obliguar të lëshojë DIT të caktuar.
- 7.2.6. Emërtimi i llogarisë pagesore është shkruar me font të theksuar, i rreshtuar nga e majta dhe nën emrin e ofruesit të shërbimeve pagesore.

7.3. Data

Ofruesi i shërbimeve pagesore shënon datën në të cilën për herë të fundit e ka përditësuar DIT-in, në madhësi dhe stil të shkronjave të përcaktuar me nënpikën (6) të pikës 5) nga kapitulli II të këtij udhëzimi, të rreshtuar nga e majta dhe nën emrin e llogarisë pagesore.

7.4. Deklaratë hyrëse

Ofruesi i shërbimeve pagesore e shënon tekstin identik në deklaratën hyrëse të shënuar në formularin nga shtojca nr. 1 nga Vendimi me hapësirë prej 1,15 dhe 0 (zero) pikë para dhe 0 (zero) pikë pas tekstit.

Ofruesi i shërbimeve pagesore i zëvendëson kllapat katrore me emërtimet përkatëse të dokumenteve parakontraktore dhe kontraktore.

7.5. Tabela të Shërbimeve dhe tarifave

- 7.5.1. Në kolonën **shërbime** shënohen vetëm termet e shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me llogarinë pagesore, të përcaktuara me Vendimin dhe të zbërthyer në nëntituj, siç është shfaqur në tabelën Shembull nr. 1

nga shtojca nr. 1 të këtij udhëzimi. Shërbimet shënohen në artikullin "shërbime" të rreshtuar nga e majta dhe me font të theksuar dhe çdo shërbim është shënuar vetëm një herë dhe në nëntitullin përkatës të kolonës në tabelë. (Për shembull, mirëmbajtja e llogarisë pagesore shënohet nën titullin "kushte të përgjithshme të lidhura me mirëmbajtjen e llogarisë").

- 7.5.2. Nëse në listën e shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me llogarinë pagesore nga Vendimi nuk është përfshirë asnjë nga shërbimet të cilat i ofrojnë ofruesit e shërbimeve pagesore, fshihet e gjithë radha me atë nëntitull, përfshirë edhe vet titullin e radhës.
- 7.5.3. Në fushën **tarifa** shënohen tariforet përkatëse për shërbimet më përfaqësuese të rreshtuara nga e djathta ndërsa në kolonën *tarifa* të nënkolona e shërbimeve më përfaqësuese mund të shënohen termet e kompensimeve nga tarifat e ofruesëve të shërbimeve pagesore për tarifa të konsumatorëve (tarifë e kompensimeve).
- 7.5.4. Nëse tarifat paguhen rregullisht dhe jo gjatë çdo përdorimi, në kolonën *Tarifë* shënohet edhe frekuenca e pagesës (për shembull mujore, vjetore dhe ngjashëm) e rreshtuar nga e majta, pas së cilës vjen tarifë përkatëse për atë periudhë, e rreshtuar nga e djathta. Tarifa totale vjetore shënohet në *tarifa totale vjetore* menjëherë nën frekuencën, me font të theksuar, e rreshtuar nga e majta, me përdorim të thënies "tarifa totale vjetore", me çka tarifa përkatëse shënohet në fushën e rreshtuar nga e djathta. Hapësira është e njëhershme, 0 (zero) pika para dhe 0 (zero) pika pas çdo shërbimi dhe tarife.
- 7.5.5. Varësisht nëse shërbimi përdoret nëpërmjet një ose më shumë kanaleve, si dhe nga rastet dhe kushtet me të cilat mundësohet e njëjta (për shembull, *vendosje fillestare e shërbimit dhe më vonë tarifë për realizimin e shërbimit - për shembull për urdhëresat e përhershme në dobi të llogarisë të personave fizik, personave juridik të ofruesi i njëjtë i shërbimeve pagesore ose te një tjetër; mujore, vjetore, me anë të telefonatës, internetit, aplikacionit celular, shuma e pragut minimal ose maksimal - për shembull për transfer kreditor në dobi të llogarisë së personave fizik, personave juridik në llogari të ofruesit të njëjtë të shërbimeve pagesore ose te një tjetër*) ofruesit e shërbimeve pagesore paguajnë tarifa të caktuara, në kolonën *tarifë* e shënojnë përshkrimin e tarifës së shërbimit në një radhë të caktuar, me atë që përshkrimi është i rreshtuar nga e majta dhe shuma e tarifës nga e djathta, për çdo përshkrim të tarifës, d.m.th. për çdo rast, kanal dhe kusht të përdorimit.
- 7.5.6. Nëse ofruesit e shërbimeve pagesore nuk ofrojnë një ose më shumë nga shërbimet më përfaqësuese ose nëse shërbimi ofrohet vetëm për llogari të caktuar, në kolonën *Tarifë* shënohet shprehja *shërbimi nuk është i disponueshëm* e rreshtuar nga e majta dhe nëse ofruesi i shërbimeve pagesore për ndonjë shërbim nuk paguan tarifë, shënohet tekst *pa tarifë* e rreshtuar nga e djathta.

- 7.5.7. Nëse tarifa të caktuara paguhen në një ose më shumë mënyra, ofruesit e shërbimeve pagesore në kolonën "tarifa" dhe në një radhë të caktuar për atë shërbim shënojnë, përshkrim për çdo rast, mënyrë ose kushte të pagesës së tarifës ("lloj të tarifës"):
- për raste të ndryshme të pagesës së tarifës për mundësimin e atij shërbimi, siç janë tarifat për prezantimin fillestar të atij shërbimi dhe pastaj, tarifa për mbajtjen e shërbimit;
 - për mënyrat e ndryshme për të cilat përdoret ose mundësohet shërbimi, për shembull me anë të telefonit, në ekspoziturë ose përmes internetit;
 - varësisht nëse janë plotësuar kushte të veçanta për shërbimin, siç është përmbushja e pragut më të ulët ose më të lartë për transfertën e kredisë ose tërheqjen e parave të gatshme;
8. Nëse tarifat paguhen në varësi të kombinimit të disa llojeve të tarifave, siç janë tarifat të cilat dallojnë sipas mënyrës, të cilat më tej ndahen në varësi të faktit nëse plotësohet një prag i caktuar gjatë pagesës së tarifës, ofruesi i shërbimeve pagesore me zbatim të paragrafit 7.5.4. nga nënpika 7.5 nga pika 7) e këtij kapitulli, e shënon edhe përshkrimin e çdo lloji të tarifës shtesë, e rreshtuar nga e djathta.
9. Nëse tarifa për mirëmbajtje të llogarisë dhe/ose mbitërheqje të lejuar dallon në varësi nga kategoria së cilës konsumatori i takon (për shembull student, pensionist, kategori e ndjeshme e konsumatorëve), ofruesi i shërbimeve pagesore në kolonën *tarifa* e shënon veçmas tarifën për secilën kategori të konsumatorit për shërbimin e mirëmbajtjes të llogarisë dhe/ose mbitërheqjen e lejuar dhe tarifa të tjera në DIT, janë të barabarta për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.
10. Ofruesi i shërbimeve pagesore e fshin **tabelën me treguesit gjithëpërfshirës të shpenzimeve**.

Përfshirë nga shembulli nr. 1 nga shtojca nr. 1 të këtij udhëzimi gjatë shfaqjes së tarifave të shërbimit për përdorim onlajn që lidhen me llogari pagesore është rasti gjatë së cilës ofruesi i shërbimeve pagesore ofron shërbim të unifikuar të internetit dhe aplikacionit celular. Në rast të tillë, ofruesi i shërbimeve pagesore e shënon markën tregtare pranë termit të shërbimit onlajn më përfaqësues në kolonën shërbim, ndërsa në kolonën tarifë i shënon termin e normës tarifore, tarifën mujore dhe tarifën totale vjetore.

11. **Pako të shërbimeve**

11.1. Nëse ofruesit e shërbimeve pagesore llogarinë pagesore e ofrojnë **si pjesë të pakos së shërbimeve** të lidhura me llogarinë pagesore **ose veçmas nga tarifat për pakot e shërbimeve** në pjesën hyrës të DIT-në, në radhën *emri i llogarisë pagesore*, e shënojnë emrin e paketës të shërbimeve në fjalë.

11.2. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të hartojnë nga një DIT për çdo pako të shërbimeve.

11.3. Gjatë shfaqjes së shërbimeve të cilat janë të përfshira me pakon e ofruesëve të shërbimeve pagesore përveç shërbimeve më të përfaqësuara të lidhura me

llogarinë pagesore nga Vendimi mund të shënohen edhe shërbime tjera të lidhura me llogarinë pagesore, por jo edhe produkte dhe shërbime që nuk janë të lidhura me llogarinë pagesore (për shembull, ndihmë mjekësore, ndihmë në rrugë, këshillë financiare, sigurim etj.)

- 11.4. Nëse ofruesit e shërbimeve pagesore e paguajnë pakon e shërbimeve të lidhur me llogarinë pagesore **si pjesë të tarifave për shërbim të mirëmbajtjes së llogarisë**, të gjitha shërbimet të cilat janë të përfshira në pakon shënohen në DIT me nëntitullin *Shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë pagesore*, në radhën për pako të shërbimeve. Në atë rast, fshihet nga DIT tabela e veçantë *Pako e shërbimeve*, e cila gjendet pas tabelës për *Shërbime dhe tarifa*.
- 11.5. Ofruesit e shërbimeve pagesore për çdo shërbim që e tejkalon sasinë e përfshirë me pakon e shërbimeve (dhe e cila nuk është shënuar në DIT me shërbimet më të përfaqësuara dhe nëse tarifa përkatëse për shërbimin dallohet nga ajo e shënuara në DIT për shërbimet më të përfaqësuara) të shënuara për tarifë shtesë, në një tabelë të veçantë me emrin Informacione mbi shërbimet shtesë në mënyrën që është e përcaktuar me këtë udhëzim.
- 11.6. Nëse numri i të gjitha shërbimeve të përfshira me pakon e shërbimeve nuk është i kufizuar, ofruesit e shërbimeve pagesore e fshijnë deklaratën në fund të radhës së *Shërbimeve të cilat i tejkalojnë këto sasi paguhen veçmas*.
- 11.7. Nëse pakoja përmban ndonjë nga shërbimet më të përfaqësuara të lidhura me llogarinë pagesore, ofruesi i shërbimeve pagesore nuk e shënon atë shërbim dhe tarifën për të në pjesën e poshtme të DIT (për shembull, onlajn, emetim të kartelës kreditore, mbitërheqja e lejuar, mirëmbajtja e llogarisë pagesore etj.).
- 11.8. Gjithë radha e cila lidhet me pakon e shërbimeve fshihet nëse pakoja e shërbimeve nuk ofrohet me kartelën pagesore dhe nëse pakoja e shërbimeve paguhet veçmas nga tarifa për mirëmbajtje të llogarisë. Gjithashtu, në atë rast fshihet edhe teksti *Shërbimet të cilat i tejkalojnë këto sasi paguhen veçmas*.
- 12.** Ofruesit e shërbimeve pagesore, pakon e shërbimeve mund ta llogarisin si pjesë të tarifave për shërbimet e mirëmbajtjes së llogarisë pagesore (shembulli nr. 2 nga shtojca nr. 1 të këtij udhëzimi)

13. Shfaqja e pakove të shërbimeve në DIT të cilat paguhen si pjesë e kompensimeve të shënuara në nëntitullin "Kushte të përgjithshme të lidhura me llogarinë"

- 13.1. Nëse pakoja e shërbimeve e cila është e lidhur me llogarinë pagesore paguhet si pjesë e tarifave të shënuara në nëntitullin "Kushte të përgjithshme të lidhura me

llogarinë”, të gjitha shërbimet të përfshira në pakon, pavarësisht nga ajo se a janë të përfshira në listën e shërbimeve më të përfaqësuara të lidhura me llogarinë pagesore nga Vendimi, shënohen në pjesën e tabelës me shërbimet e përgjithshme të lidhura me llogarinë, në radhën pako të shërbimeve.

13.2. Ofruesi i shërbimeve pagesore i shënon informacionet për tarifë shtesë për çdo shërbim që e kalon sasinë e cila është e përfshirë me pakon e shërbimeve në një tabelë të caktuar nën titullin Informacione mbi shërbimet shtesë.

13.3. Nëse numri i të gjitha shërbimeve të përfshira me pakon e shërbimeve nuk është i kufizuar, ofruesi i shërbimeve pagesore e fshinë deklaratën në fund të radhës “shërbimet të cilat e tejkalojnë këtë sasi paguhen veçmas”.

13.4. Nëse pakoja e shërbimeve ofrohet me llogarinë pagesore dhe nëse pakoja e shërbimeve paguhet veçmas nga cilido kompensim për kushte të përgjithshme të lidhura me llogarinë pagesore e gjithë radha e cila ka të bëjë me pakon e shërbimeve fshihet.

14. Shfaqja e pakove të shërbimeve në DIT të cilat paguhen **veçmas nga tarifat e shënuara në nëntitullin “Kushte të përgjithshme të lidhura me llogarinë”**

14.1. Nëse ofruesi i shërbimit pagesore së bashku me llogarinë ofron pako të shërbimeve të lidhura me llogarinë pagesore e cila paguhet veçmas nga të gjitha tarifat tjera me nëntitull “kushte të përgjithshme të lidhura me llogarinë”, siç është e shënuar në tabelën me shërbimet dhe tarifat, ofruesi i shërbimeve pagesore në tabelën e pakos së shërbimeve i paraqet informacionet në vijim:

- pasqyrë e të gjitha shërbimeve të përfshira në pakon, pavarësisht nga ajo se a janë të përfshirë në listën e shërbimeve më të përfaqësuara të lidhura me llogarinë pagesore nga Vendimi.
- sasia e çdo shërbimi të përfshirë me tarifën për pakon e shërbimeve, që mund të jetë ose numër ose shenjë se numri i shërbimeve nuk është i kufizuar;
- kompensim për paketë, në kolonën *tarifë*, e rreshtuar nga e djathta.

14.2. Nëse pakoja e shërbimeve paguhet rregullisht, frekuenca shënohet në kolonën “tarifë”, e rreshtuar nga e majta, ndërsa tarifa totale vjetore në radhën para frekuencës, me font të theksuar dhe me përdorim të shprehjes *tarifë totale vjetore*.

14.3. Ofruesi i shërbimeve pagesore i shënon informacionet për tarifë shtesë për çdo shërbim që e kalon sasinë e cila është e përfshirë me pakon e shërbimeve siç është e përcaktuar në këtë udhëzim.

14.4. Nëse numri i të gjitha shërbimeve të përfshira nuk është i kufizuar, ofruesi i shërbimeve pagesore e fshinë deklaratën në fund të tabelës *Shërbimet të cilat i tejkalojnë këto sasi tarifohen veçmas*.

14.5. Nëse në dokumentin informativ për tarifa janë të përfshira më shumë pako, ofruesi i shërbimeve pagesore shënon informacione në pajtim me këtë pikë në tabelë të veçantë për çdo pako, duke shënuar dhe markën tregtare të pakos së shërbimeve nëse është e aplikueshme.

14.6. Ofruesi i shërbimeve pagesore e fshinë të gjithë tabelën nëse me llogarinë pagesore nuk ofrohet pako e shërbimeve ose nëse pakoja e shërbimeve paguhet si pjesë nga kompensimi për cilindo lloj të shërbimeve të përgjithshme të lidhura me llogarinë.

14.7. Nëse ofruesi i shërbimeve pagesore ofron llogari pagesore si pjesë të pakos me shërbime tjera të lidhura me llogarinë pagesore por atë pako e ofron dhe e **paguan veçmas nga shërbimi mirëmbajtje të llogarisë**, e fshin të gjithë radhën në DIT e cila ka të bëjë me pakon e shërbimeve e cila gjendet në nëntitullin *Kushte të përgjithshme të lidhura me llogarinë dhe fjalinë Shërbimet që tejkalojnë sasinë e specifikuarat faturohen veçmas*. Pakon e tillë të shërbimeve me llogari pagesore ofruesi i shërbimeve pagesore e shfaq në tabelë të veçantë DIT-në me titull *Pako të shërbimeve* dhe i shënon informacionet të cilat janë të përcaktuara me kapitullin XI të këtij udhëzimi.

14.8. Sikur edhe te DIT-i pa paketë, nëse ofruesi i shërbimeve pagesore përdor *markë tregtare*, mund ta shënojë menjëherë pas emërimit të shërbimeve në kllapat katrore me madhësi dhe stil të fontit. Ofruesi i shërbimeve pagesore është i detyruar t'ia bëjë konsumatorit të disponueshëm edhe **fjalorthin** (kapitulli IV nga ky udhëzim).

14.9. Në tabelën **Informacione mbi shërbimet shitesë** shënohen informacione shitesë për çdo shërbim që e tejkalon sasinë e shërbimeve të përfshira me pakon, nëse informacionet e tilla tashmë nuk janë të shënuara në tabelën Shërbime dhe tarifa ose nëse tarifimi përkatës për shërbimin dallon nga ajo e shënuar në tabelë (për shembull, deri në shumën prej 10.000 mkd kompensimi për shërbimin tarifohet në një mënyrë, ndërsa mbi atë shumë në mënyrë tjetër).

14.10. Nëse ofruesi i shërbimit ofron më shumë se një pako dhe tarifimet ndryshojnë varësisht nga pakoja, ofruesi i shërbimeve pagesore i shënon tarifimet e ndryshme për çdo pako dhe nëse është e nevojshme përdor markë tregtare.

14.11. Nëse ofruesi i shërbimeve pagesore jep DIT-i **pa paketë të shërbimeve** e fshin tabelën nga pika 14.9.

14.12. Ofruesi i shërbimeve pagesore mund të hartojë më shumë dokumente informative për tarifën për llogari, me kusht që çdonjëra prej dokumenteve informative për tarifë të përmbajë majde një pako.

IV. FJALORTHIN

15. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar që konsumatorit, së bashku me DIT ti japin edhe Fjalorthin. Fjalorthi nuk është dokument i standardizuar, por patjetër duhet t'i përfshijë së paku termet dhe definicionet për shërbimet më të përfaqësuara të lidhura me llogari pagesore të përcaktuara me vendimin.

Fjalorthi paraqet dokument të veçantë, broshurë, fletushkë etj., nuk është pjesë përbërëse e DIT-së dhe nuk duhet të jetë në pjesën e pasme të DIT-it.

16. Ofruesit e shërbimeve pagesore mundet së bashku me termet dhe definicionet për shërbimet më të përfaqësuara në Fjalorthin të shtojnë edhe terme tjera dhe shpjegime me qëllim që konsumatorët ta kuptojnë më mirë domethënien e tarifave të caktuara.

17. Fjalorthi duhet të jetë i shkruar në mënyrë të thjeshtë, të sublimuar, transparente dhe të qartë me madhësi të fontit të lexueshëm lehtë, ku termet dhe definicionet që i përmban nuk duhet të jenë të paqarta.

V. RAPORT I TARIFAVE (RT)

18. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar t'i japin ose të ja bëjnë të disponueshme konsumatorit *Raportin e tarifave* të përcaktuar në Shtojcën 2 nga Vendimi (në tekstin e mëposhtëm: formular RT ose RT) (*ang. Statement of Fees*), e cila përmban informacione për të gjitha interesat dhe tarifat e llogaritura, si dhe interesat e fituara(pasive) të cilat paraqiten me përdorimin e llogarisë pagesore të konsumatorit dhe shërbimet që lidhen me llogarinë.

19. Raporti për tarifat i jepet konsumatorit ose është i disponueshëm në mënyrën për të cilën konsumatori është shprehur gjatë nënshkrimit të marrëveshjes kornizë për përdorim të shërbimeve pagesore, domethënë në mënyrën e komunikimit ashtu si i pranon konsumatori dokumentet (për shembull: Certifikatë nga gjendja e llogarisë në letër, email, në kuadër të internet bankimit, në ekspozitura etj.) në pajtim me vlefshmërinë së marrëdhënieve kontraktuese.

20. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar ta përdorin formularin e Raportit të tarifave dhe t'a plotësojnë duke u përmbajtur në përmbajtjen, formën, simbolet, madhësinë dhe stilin e fontit, ngjyrës, ndarjen dhe shtrirjen e tekstit siç është përshkruar me këtë udhëzim njëkohësisht duke e respektuar renditjen e informacioneve, titullin dhe nëntitullin e kolonave të përcaktuara në formularin RT. RT-ja detyrimsht:

- të shfaqet në formatin A4, me orientim vertikal;
- të shkruhet në ngjyrë të bardhë dhe të zezë;
- përmban logon e ofruesit të shërbimeve pagesore dhe simbol të përbashkët 2,5 cm x 2,5 cm i cili duhet të jetë i shfaqur në pajtim me propozimin e përcaktuar në formularin RT; logoja e ofruesit të shërbimeve pagesore dhe simboli i përbashkët duhet të jenë të shfaqur në ngjyrë me që logoja e ofruesit të shërbimeve pagesore duhet të jetë në madhësi të njëjtë sikur simboli i përbashkët; bardh dhe zi, simboli i qartë dhe i lexueshëm; logoja e ofruesit të shërbimeve pagesore mund të jetë në ngjyrë vetëm nëse simboli i përbashkët është në ngjyrë dhe përdoret shembull të ngjyrës me numër referues 0/51/153 (hyrje heksadecimale: 003399), model i ngjyrës RGB për prapavijë dhe shembull ngjyra 255/204/0 (hyrje heksadecimale: FFCC00) me model të ngjyrës RGB për simbol.
- përmban titullin "Raport për tarifat" në krye të faqes së parë, i cili është i pozicionuar në qendër edhe është mes logos së ofruesit të shërbimeve pagesore në këndin e sipërm të majtë të dokumentit dhe simbolit të përbashkët në këndin e djathtë të sipërm të dokumentit;
- përmban titull të kolonave në ngjyrë gri gjysmë të errët, duke përdorur një shembull ngjyrash me numër referues 166, 166, 166 në model të ngjyrave RGB dhe nëntitujt në kolonat me ngjyrë gri të hapur, duke përdorur shembull të ngjyrës me numër referues e 191,191, 191 me model të ngjyrave RGB;
- është në Arial ose tjetër të ngjashëm me Arial, madhësi të shkronjave 11, përveç titullit "Raport i tarifave", i cili duhet të printohet me shkronja të zeza me madhësi 16, titujt e kolonave me shkronja të zeza me madhësi 14, si dhe nëntitujt të kolonave të cilat duhet të printohen me shkronja të zeza me madhësi 12, përveç nëse zmadhimi i shkronjave ose përdorimi i alfabetit Brajt për personat me shikim të

- dëmtuar është bërë marrëveshje mes konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve pagesore;
- kompensimet në RK-në; shfaqen në denarë, ndërsa në valutë tjetër vetëm për jo rezidentë dhe nëse e njëjta është dakorduar mes ofruesit të shërbimeve pagesore dhe konsumatorit;
 - është me faqe të numëruara.
21. Nëse kartela pagesore e konsumatorit është **pa tarifim**, d.m.th. që për atë nuk janë llogaritur tarifat dhe interesi në periudhën kalendarike për të cilën është emetuar RT-ja, ofruesi i shërbimeve pagesore mund t'i dorëzojë konsumatorit Raport të tarifave.
22. Nëse bëhet fjalë për llogari jo aktive, ofruesi i shërbimeve pagesore, mundet t'i dërgojë konsumatorit raport për tarifat.
23. Nëse llogaria pagesore e konsumatorit është e bllokuar, ofruesi i shërbimeve pagesore në RT-në e shfaq të gjitha kompensimet të cilat ja ka llogaritur konsumatorit në periudhën kalendarike për të cilën është emetuar RK
- ja, pavarësisht të pagesës së vonshme.

VI. MËNYRA DHE STANDARDET TEKNIKE PËR PLOTËSIMIN E RK-së

24. Në vazhdim të këtij udhëzimi janë shënuar udhëzime të detajuara lidhur me mënyrën dhe standardet teknike të plotësimit të pjesëve të caktuara nga RK-ja.

24.1. Emri i ofruesit të shërbimeve pagesore

Ofruesi i shërbimeve pagesore i zëvendëson emërtimet në kllapat nga formulari RT me emrin, adresën, numrin e telefonit, adresën e e-postës, numrin e faksit, internet - adresën dhe personin ose pikën qendrore për kontakt, të cilat përdoruesi i shërbimeve pagesore në emër të së cilit ofruesi i shërbimeve pagesore e hap dhe e mirëmban llogarinë pagesore (në tekstin e mëposhtëm: bartësi i llogarisë pagesore) mund ti përdorë në korrespondencën e ardhshme, e shkruar me font të zeza dhe e rreshtuar nga e majta.

24.2. Emri dhe të dhënat për kontakt të bartësit të llogarisë pagesore

Ofruesi i shërbimeve pagesore në kllapa katrore nga formulari RT e shënon emrin dhe mbiemrin, si dhe adresën (adresën të cilën konsumatori e ka shënuar për komunikim) të bartësit të llogarisë pagesore të shkruar me shkronja të zeza, të rreshtuar nga e majta dhe me shkronja të vogla, përveç shkronjës së parë të çdo fjale.

24.3. Llogaria pagesore

Ofruesit e shërbimeve pagesore e shënojnë emrin e llogarisë pagesore për të cilën emetohet RT-ja (për shembull llogari pagesore në denarë, llogari pagesore në euro, etj.) dhe/ose kategori e konsumatorëve (për shembull punonjës, pensionerë, konsumatorë të cilët i takojnë grupit të përdoruesëve me të drejta ligjore të caktuara etj.) me font të theksuar, e rreshtuar nga e majta dhe pas fjalëve përkatëse.

Tarifat për kartelën kreditore të konsumatorit i cili ka hapur më shumë llogari te një ofrues i caktuar i shërbimeve pagesore shfaqen në RT-në e llogarisë pagesore me numrin më të madh të transaksioneve në periudhën kalendarike për të cilën lëshohet RT-ja.

24.4. Shenja e identifikimit të llogarisë

Ofruesit e shërbimeve pagesore e shënojnë IBAN-in (numri ndërkombëtar i llogarisë pagesore), BBAN-in (numri bazë identifikues i llogarisë pagesore tek ofruesi i shërbimeve pagesore) ose një shenjë tjetër identifikuese të llogarisë pagesore. Këto të dhëna rreshtohen nga e majta.

24.5. Periudha

Ofruesit e shërbimeve pagesore e shënojnë periudhën kalendarike për të cilën emetohet RT-ja në radhën *periudha* e cila është e përfshirë me tarifat, e rreshtuar nga e majta.

24.6. Data

Ofruesit e shërbimeve pagesore në radhën *data* e shënojnë datën kalendarike në të cilën është emetuar RT-ja, e rreshtuar nga e majta.

24.7. Deklaratë hyrëse

Shënohet tekst identik me deklaratën hyrëse të shënuar në formularin RT siç është përcaktuar në shtojcën 2 nga vendimi me hapësirë prej 1,15 dhe 0 (zero) pikë para dhe 0 (zero) pikë pas tekstit.

24.8. Shfaqje subline e tarifave dhe interesit

Ofruesit e shërbimeve pagesore në katër tabela ndarazi nën titullin *Shfaqje subline e tarifave dhe interesit* (shembulli nr. 3 nga shtojca nr. 1 e këtij udhëzimi) i listojnë shumat totale të tarifës dhe interesit të paguar, me font të trashë dhe anësuar nga e majta, ku shuma e tarifave është e shënuar në denarë, përkatësisht:

- Në tabelën *Gjithsej tarifa të paguara* (gjithsej *tarifa* për shërbimet e paketës dhe gjithsej *tarifa* të paguara) shkruhet shuma totale e të gjitha tarifave të ngarkuara në periudhën kalendarike për të cilën është lëshuar RT-ja, dhe e cila duhet të jetë e
- barabartë me shumën që është shënuar në një tabelë të veçantë të RK-së me titullin *Raportim i detajuar i tarifave të paguara për llogari*, në rreshtin *Gjithsej tarifa të paguara*.
- Në tabelën *Gjithsej interesi i paguar* shkruhet shuma totale e të gjitha interesave të përllogaritura (aktive dhe gjoba). Kjo shumë duhet të jetë e barabartë me shumën totale që është shënuar në RT në tabelë të veçantë të titulluar *Shfaqje e detajuar e interesit të paguar në llogari*, në rreshtin *Gjithsej interesi i paguar*. Nëse interesi nuk zbatohet në llogari të caktuar pagesore ose nëse përfshirja e informacionit të tillë mundësohet ose parashikohet me rregullore të tjera kombëtare, ofruesit e

shërbimeve pagesore paraqesin tekstin "interesi nuk zbatohet", me shkronja të vogla të anuara djathtas. Nëse interesi zbatohet, por për periudhë të caktuar është zero, ofruesit e shërbimeve pagesore paraqesin shumën prej 0,00 MKD në tabelën përkatëse.

- në tabelën *Gjithsej interesi i fituar* paraqiten të gjitha interesat pasive. Kjo shumë duhet të jetë e barabartë me shumën totale që është shënuar në RT-në në tabelë të veçantë të titulluar *Shfaqje e detajuar e interesit të paguar në llogari*, në rendin *Gjithsej interesi i fituar*. Nëse interesi nuk zbatohet në llogari të caktuar pagesore, ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të deklarojnë tekstin: *interesi nuk zbatohet*. Nëse interesi zbatohet në mënyrë të caktuar, por për periudhë të caktuar shuma është zero, shënohet shuma **0,00** në tabelën përkatëse.
- ofruesit e shërbimit pagesor e fshijnë tabelën *Tregues gjithëpërfshirës i kostos*.

24.9. Raport i detajuar mbi tarifën e paguar për llogarinë pagesore

24.9.1. Në pjesën e RT-së me titullin *Raport i detajuar mbi tarifën e paguar në llogarinë pagesore*, ofruesit e shërbimeve pagesore i listojnë të gjitha tarifat të cilat janë kryer në periudhën kalendarike për të cilën lëshohet RT-ja për shërbimet përkatëse.

24.9.2. RT-ja përmban informacione mbi të gjitha tarifat e ngarkuara për shërbimet që lidhen me llogarinë pagesore, jo vetëm tarifat për shërbimet më përfaqësuese. Me përcaktimin se cilat tarifa do të paraqiten në RT-në dhe cilat jo, duhet të merret parasysh përkufizimi i shërbimeve në lidhje me llogarinë pagesore nga Ligji, si dhe cilat shërbime janë të lidhura ngushtë me to.

24.9.3. Kjo tabelë është e ndarë në dy pjesë, respektivisht kolona *shërbime* dhe *tarifa*. Kolona *shërbime* përbëhet nga dy nënkolona *shërbime* dhe *sa herë është përdorur shërbimi*, ndërsa kolona *tarifa* përbehet nga tre nënkolona *çmimi për njësi*, *sa herë është tarifuar shërbimi* dhe *gjithsej*.

24.9.4. Ofruesit e shërbimeve pagesore listojnë shërbimet në nënkolonën *shërbime* me shkronja të theksuara të zeza dhe të rreshtuara majtas, me një distancë të vetme, 0 (zero) pika përpara dhe 0 (zero) pika pas çdo shërbimi.

24.9.5. Ofruesit e shërbimeve pagesore në nënkolonën *sa herë është përdorur shërbimi* listojnë sa herë është përdorur secili shërbim gjatë periudhës përkatëse kalendarike i mbuluar nga raporti i tarifave, të rreshtuara në të majtë dhe me stilin dhe madhësinë e shkronjave të përshkruara në nënpika (6), pika 20 e kapitullit V të këtij udhëzimi.

24.9.6. Ofruesit e shërbimeve pagesore lënë të zbrazët nënkolonën *sa herë është përdorur shërbimi* në rastet kur shërbimi është përdorur, megjithatë ofruesi i shërbimeve pagesore nuk ka paguar tarifë për atë shërbim.

24.9.7. Në nënkolonën *shërbime* listohen terminologjitë e **shërbimeve më përfaqësuese nga Vendimi** si dhe terminologjitë e **të gjitha shërbimeve të tjera** në lidhje me llogarinë pagesore për të cilat janë paguar tarifat në periudhën përkatëse, sipas terminologjisë ekzistuese nga **tarifa** e kompensimeve të çdo ofruesi të veçantë të shërbimit pagesor.

24.9.8. Shërbimet më përfaqësuese për të cilat paguhen tarifa duhet të ndahen, nëse ato janë paguar në periudhën kalendarike në fjalë, në nëntitujt (nënkategoritë) e tabelës *Raport i detajuar mbi tarifat e paguara për llogari* në të njëjtën mënyrë siç ndahen në RT-në Shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë (Mirëmbajtja e llogarisë, onlajn); Pagesa (përveç kartelave) Transferta të kredisë në denarë në vend; Transferta të kredisë në euro jashtë vendit; Transferta të kredisë në valutë të ndryshme nga euroja jashtë vendit; Hyrje nga jashtë; Urdhërpagesa e përherëshme), Kartela dhe para të gatshme (Lëshimi i kartelave të debitit; Lëshimi i kartelave të kreditit; tërheqja e parave të gatshme); Mbitërheqja e lejuar dhe shërbimet e ngjashme (Mbitërheqja e lejuar) dhe Shërbime të tjera.

24.9.9. Në paraqitjen e tarifave të ngarkuara për kartelat, në RT-në është e nevojshme të tregohen tarifat e ngarkuara për të gjitha kartelat që konsumatori ka përdorur për periudhën për të cilën është lëshuar RT-ja.

24.9.10. Shërbimet e tjera që lidhen me llogarinë pagesore për të cilat paguhen tarifat, por shërbime të cilat nuk janë më përfaqësuese, duhet të ndahen në nënkategori të specifikuara sipas kuptimit të tyre, respektivisht, thelbit të secilit shërbim.

24.9.11. Të gjitha shërbimet për të cilat paguhen tarifa, dhe për nga thelbi i tyre nuk korrespondojnë me asnjë nga nënkategoritë e specifikuara në tabelë, janë renditur nëntitullin *Shërbime të tjera* (për shembull, rilëshimi i PIN-it, rilëshimi i kartelës, dërgimi i raportit shtesë sipas kërkesës, etj.).

24.9.12. Ofruesit e shërbimeve pagesore e fshijnë nëntitullin që nuk përmban asnjë shërbim për të cilin është ngarkuar tarifë nga ofruesi i shërbimit pagesor ose nëse mbajtësi i llogarisë pagesore nuk ka përdorur numër shtesë të shërbimeve përveç atyre falas të përcaktuara në paketën e shërbimeve për kohëzgjatjen e periudhës përkatëse.

24.9.13. Ofruesit e shërbimeve pagesore që përdorin **markë tregtare** mund ta përfshijnë atë pas përshkrimit të shërbimit në kllapa katrore.

24.9.14. Në nënkolonën *sa herë është përdorur shërbimi* listohet se sa herë është përdorur secili prej shërbimeve për kohëzgjatjen e periudhës përkatëse të mbuluar nga RT-ja. Ofruesit e shërbimit pagesor në nënkolonën përkatëse, specifikojnë tekstin *shërbimi nuk tarifohet* në rastet e mëposhtme:

(1) shërbimi është përdorur, por ofruesi i shërbimeve pagesore nuk vendos pagesë tarife për atë shërbim, dhe

(2) përfshirja e informacionit të tillë mundësohet ose parashikohet nga rregulloret kombëtare.

24.9.15. Në nënkolonën *çmimi për njësi*, listohet struktura e çmimit për njësi dhe kostoja e secilit shërbim që është përdorur. Për artikujt për të cilët nuk paguhet tarifë ose tarifa është 0,00, gjithmonë shkruhet 0,00 MKD. Nëse tarifa ka ndryshuar gjatë periudhës raportuese, është e nevojshme në nënkolonën *shërbime*, të listohet periudha në të cilën paguhet tarifë gjegjëse dhe kolonat tjera në tabelë të ndahen në rreshta dhe të plotësohen në mënyrën e duhur.

24.9.16. Në nënkolonën *sa herë është përdorur shërbimi* shënohet se sa herë është paguar secila prej shërbimeve për kohëzgjatjen e periudhës përkatëse të mbuluar nga raporti i tarifave ose listohet teksti *tarifa është e papaguar*, e rreshtuar në të djathtë.

24.9.17. Në nënkolonën *gjithsej* listohet shuma totale e tarifave për përdorimin e atij shërbimi gjatë periudhës përkatëse kalendarike (çmimi për njësi x numri sa herë është paguar tarifa). Shuma është e shënuar në denarë me shkronja të theksuara.

24.9.18. Nëse nëntitulli nuk mbulon asnjë nga shërbimet, ofruesit e shërbimeve pagesore e fshijnë nëntitullin *shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë*. Ofruesit e shërbimeve pagesore e fshijnë atë nëntitull dhe nëse mbajtësi i llogarisë pagesore nuk ka përdorur shërbime përveç brenda shumës së paketave të shërbimeve të përcaktuara gjatë gjithë periudhës përkatëse.

24.9.19. Nëse konsumatori nuk ka përdorur asnjë shërbim nga ndonjë nëntitull i caktuar (shembulli nr. 4 nga shtojca nr. 1 e këtij udhëzimi *Shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë*) dhe nuk është paguar asnjë tarifë nën atë nëntitull, ofruesit e shërbimeve pagesore e fshijnë atë nëntitull nga RT-ja.

24.9.20. Përderisa ofruesi i shërbimit pagesor paguan tarifa veçmas **për një ose më shumë llogari** (për shembull, tarifa për krijimin dhe përdorimin e atij shërbimi), tarifa në varësi të mënyrës se si ofrohen këto shërbime (me telefon, në ekspoziturë, në internet, etj.) ose tarifa varësisht nëse është realizuar ndonjë kusht (për shembull, shuma më e vogël ose më e madhe për një transfertë kredie ose tërheqje parave të gatshme, etj.), ofruesi i shërbimeve pagesore në tabelën *Raport i detajuar i tarifave të paguara për llogari* në kolonën *shërbime*, për shërbimin përkatës, në rresht të veçantë e shkruan përshkrimin e çdo rasti, mënyrën ose gjendjen e interesit të paguar.

24.10. Raport i detajuar mbi interesin e paguar për shërbimet që lidhen me llogarinë pagesore

24.10.1. Në tabelën ***Raport i detajuar mbi interesin e llogaritur për shërbimet që lidhen me llogarinë pagesore*** (shembulli nr. 5 nga shtojca nr. 1 e këtij udhëzimi) nga RT-ja ofruesit e shërbimeve pagesore paraqesin normën e interesit (aktive dhe

gjobën) dhe shumën e interesit në denarë të cilat i ngarkohen konsumatorit për kohëzgjatjen e periudhës kalendarike për të cilën krijohet RT-ja.

24.10.2. Në kolonën *norma e interesit* renditet norma e interesit e llogaritur në bazë vjetore. Nëse norma e interesit ka ndryshuar për kohëzgjatjen e periudhës përkatëse kalendarike, ofruesi i shërbimeve pagesore liston secilën nga normat e interesit që është zbatuar në kohëzgjatjen e secilës prej periudhave në një rresht të veçantë.

24.10.3. Në kolonën *interesi* ofruesi i shërbimit pagesor e liston shumën e interesit që është paguar nga konsumatori, të shprehur në denarë ose në valutën e llogarisë pagesore dhe me shkronja të theksuara. Nëse norma e interesit ka ndryshuar për kohëzgjatjen e periudhës përkatëse kalendarike, ofruesi i shërbimeve pagesore liston shumën totale të normës së interesit që është paguar, veçmas në një rresht të veçantë.

24.10.4. Në rreshtin *gjithsej interesi i paguar* ofruesi i shërbimeve pagesore liston totalin e interesit që mbajtësi i llogarisë pagesore tarifohej për periudhën kalendarike për të cilën është krijuar RT-ja, me font të theksuar.

24.10.5. Nëse mbajtësit të llogarisë pagesore nuk i paguhet interes, sepse nuk zbatohet për atë llogari pagesore, ofruesi i shërbimeve pagesore në këtë rresht shkruan tekstin *interesi nuk zbatohet*, rreshtuar majtas, me font të theksuar, në rreshtin *gjithsej interesi i paguar*.

24.11. Raport i detajuar mbi interesin e fituar në llogarinë pagesore

24.11.1. Në tabelën *Raport i detajuar mbi interesin e fituar në shërbimet që lidhen me llogarinë pagesore* (shembulli nr. 6 nga shtojca nr. 1 e këtij udhëzimi) ofruesit e shërbimeve pagesore shkruajnë normën pasive të interesit dhe shumën e interesit në denarë, të cilat i paguhen konsumatorit për kohëzgjatjen e periudhës kalendarike për të cilën hartohet RT-ja.

24.11.2. Ofruesi i shërbimeve pagesore e zëvendëson tekstin *emri i llogarisë* në tabelë me emrin që është i përshtatshëm për atë llogari pagesore, me font të theksuar.

24.11.3. Nëse për llogarinë zbatohet norma e interesit, në kolonën *norma e interesit* ofruesit e shërbimeve pagesore e listojnë normën e interesit si përqindje e cila zbatohet në bazë vjetore. Nëse norma e interesit ka ndryshuar për kohëzgjatjen e periudhës përkatëse kalendarike, ofruesit e shërbimeve pagesore listojnë secilën nga normat e interesit që është zbatuar në kohëzgjatjen e secilës prej periudhave në një rresht të veçantë.

24.11.4. Në kolonën *interesi* ofruesi i shërbimeve pagesore e liston shumën e interesit në denarë ose të shprehur në valutë tjetër të llogarisë pagesore dhe e printuar me font të zi, të cilën e ka fituar mbajtësi i llogarisë pagesore. Nëse norma e interesit ndryshon gjatë kohëzgjatjes të periudhës që mbulon RT-ja, ofruesit e shërbimeve pagesore e

listojnë interesin të cilin mbajtësi i llogarisë pagesore e ka fituar veçmas për secilën nga periudhat përkatëse, secila në një rresht të veçantë.

24.11.5. Nëse norma e interesit është e zbatueshme, por për një periudhë të caktuar është 0 (zero), ofruesit e shërbimeve pagesore në kolonën *interesi* shkruajnë 0,00 denarë.

24.11.6. Nëse për llogari pagesore të caktuar interesi nuk është i zbatueshëm, ofruesit e shërbimeve pagesore në kolonën *interesi* e listojnë tekstin *interesi nuk zbatohet* me shkronja të vogla, të anuara majtas.

24.11.7. Në rendin *gjithsej interesi i fituar* ofruesit e shërbimeve pagesore e listojnë shumën totale të interesit në denarë, të cilin mbajtësi i llogarisë pagesore e ka fituar gjatë gjithë periudhës që e mbulon RT-ja.

24.12. Shfaqja e paketës së shërbimeve në RT

24.12.1. Siç është e theksuar në DIT, ofruesi i shërbimeve pagesore mund të tarifojë paketën e shërbimeve në lidhje me llogarinë pagesore si pjesë të tarifës për shërbimin e mirëmbajtjes së llogarisë ose veçmas.

24.12.2. Ofruesi i shërbimit pagesor përpunon një RT për një paketë shërbimi.

24.12.3. Rrjedhimisht, ofruesi i shërbimit pagesor është i detyruar që për paketën e tillë të shërbimeve t'ia jap ose t'ia bëjë të disponueshme konsumatorit në RT me tarifë e paguara për atë paketë për periudhën kalendarike të caktuar. Ofruesi i shërbimit pagesor paketat e këtilla i liston në RT në pajtueshmëri me këtë udhëzim.

24.12.4. Nëse ofruesi i shërbimeve pagesore **paguan** paketën e shërbimeve si **pjesë të tarifës** për shërbimin e mirëmbajtjes së llogarisë, ofruesi i shërbimeve pagesore në tabelën *Raport i detajuar i tarifave të paguara për llogarinë*, në nëntitullin *Shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë*, nënkolona *shërbime* dhe në rreshtin *paketa të shërbimeve* listohen informacionet për shumën e të gjitha shërbimeve të përfshira në paketë (në mënyrë të njëjtë si me shërbimet e listuara në RT-në, pa dallim nëse konsumatori ka shfrytëzuar të gjithë ose pjesërisht shërbimet e paketës) dhe në nënkolonën *sa herë është shfrytëzuar shërbimi* listohet sa herë konsumatori ka shfrytëzuar paketën.

24.12.5. Në kolonën *tarifat*, nënkolonën *çmimi për njësi* ofruesi i shërbimeve pagesore e liston tarifën e cila paguhet për paketë si tërësi dhe në nënkolonën *sa herë është paguar tarifa* listohet sa herë është paguar tarifë për paketën për periudhën kalendarike të caktuar, në radhe të veçantë.

24.12.6. Të gjitha tarifat të cilat paguhet për shërbimet të cilat e kalojnë sasinë që mbulohet nga paketa e shërbimeve, listohen në tabelën *Raport i detajuar i tarifave të paguara për llogarinë* në vijim të RT-së, me listë të shërbimeve dhe tarifave. Nëse

numri i shërbimeve në paketë nuk është i kufizuar ose sasi të falas të shërbimeve që mbulohen nga paketa nuk janë tejkaluar, ofruesi i shërbimeve pagesore e fshin fjalinë që thotë *shërbimet që tejkalojnë këto sasi faturohen veçmas*.

24.12.7. Nëse mbajtësi i llogarisë pagesore nuk ka përdorur shërbime përveç brenda sasive falas të treguara në paketën e shërbimeve gjatë periudhës përkatëse, ofruesit e shërbimeve pagesore fshijnë titullin përkatës për atë shërbim në RT-në.

24.12.8. Nëse ofruesi i shërbimit pagesor faturon paketa të shërbimeve **si pjesë e tarifës** për shërbimin e mirëmbajtjes së llogarisë, tabela e veçantë në RT-në me titullin *raporti i detajuar i tarifave të përfshira në paketën e shërbimeve*, fshihet nga RT-ja.

24.12.9. Nëse paketat e shërbimeve të lidhura me llogarinë pagesore ofrohen me llogarinë pagesore dhe paguhen si pjesë e tarifës në nëntitullin *kushtet e përgjithshme në lidhje me llogarinë pagesore*, ofruesit e shërbimit pagesor në tabelën *Raport i detajuar mbi tarifën e paguar për llogarinë pagesore* në rreshtin *paketa e shërbimeve* gjithashtu listojnë informacione për ofertat e përfshira në paketën në kolonën *shërbime* si dhe sa herë është përdorur paketa në kolonën *sa herë është shfrytëzuar paketa*. Në nëntitullin *tarifë* ofruesit e shërbimeve pagesore e listojnë tarifën e cila paguhet për paketën si tërësi, si dhe sa herë është paguar tarifë për paketën gjatë periudhës, ashtu si është sqaruar në këtë udhëzim. Rreshti fshihet nëse pakoja e shërbimeve faturohet veçmas nga tarifën e shërbimeve të përgjithshme të lidhura me llogarinë pagesore.

24.12.10 Të gjithë tarifën të cilat paguhen për shërbimet të cilat e tejkalojnë sasinë e mbuluar nga paketa janë dhënë në tabelën ku renditen shërbimet dhe tarifën e përcaktuara në këtë udhëzim.

24.12.11. Nëse numri i shërbimeve pagesore nuk është i kufizuar ose sasi të shërbimeve që mbulohen nga paketa nuk janë tejkaluar, ofruesit e shërbimeve pagesore e fshijnë deklaratën në fund të tabelës *shërbimet që i tejkalojnë këto sasi paguhen veçmas*.

24.12.12. Në rast se ofruesi i shërbimeve pagesore ofron llogari pagesore konsumatorit në paketë me shërbime tjera të lidhura me llogarinë pagesore, por, ajo paketë ofrohen dhe **paguhet veçmas nga shërbimi i mirëmbajtjes së llogarisë**, ofruesi i shërbimit pagesor e fshin të gjithë rreshtin nga RT-ja në tabelën *Njoftim i detajuar i tarifave të paguara për llogari*, në nëntitullin *Shërbime të përgjithshme në lidhje me llogarinë*, të cilat kanë të bëjnë me paketën e shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve pagesore e paraqet paketën e tillë në tabelë të ndarë në RT-në nën titullin *Raport i detajuar i tarifave të përfshira në paketën e shërbimeve* dhe liston informacione të përshkruara në nënpikën 24,9) të pikës 24 të këtij udhëzimi.

24.13. Paraqitja e paketës së shërbimeve të paguara veçmas nga tarifën e listuar në nëntitull *kushte të përgjithshme të lidhura me llogarinë pagesore*

24.13.1. Nëse ofruesi i shërbimeve pagesore ofron paketa të shërbimeve të lidhura me llogarinë pagesore e cila paguhet veçmas nga të gjitha tarifat tjera me nëntitull *Kushte të përgjithshme të lidhura me llogarinë pagesore* për shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë pagesore siç është e shënuar në tabelën me shërbimet dhe tarifat, ofruesi i shërbimeve pagesore në tabelën me shërbimet e paketës i liston informacionet vijuese:

- në kolonën për *shërbimet e paketës*, marka tregtare, sipas nevojës, ose përmbajtjen e paketës, duke fshirë kllapat katrore.
- Në kolonën për *tarifë* paraqitet tarifa e cila paguhet për paketën si tërësi për periudhën që mbuloj RT-ja, e rreshtuar në të djathtë.
- kolona e tretë tregon se sa herë është paguar tarifa për paketën në periudhën përkatëse.

24.13.2. Çdo tarifë shtesë e paguar për shërbime që i tejkalon shumat e mbuluara nga tarifa për paketat e shërbimeve janë renditur në tabelën për shërbimet dhe tarifat.

24.13.3. Nëse paketa faturohet rregullisht, në kolonën *tarifë* specifikohet frekuenca e pagesës, rreshtuar majtas, dhe në rreshtin menjëherë pas saj është tërësia e tarifës vjetore, me shkronja të theksuara, me tekstin *gjithsej tarifë vjetore*.

24.13.4. Në rast se për paketa të ndryshme të periudhës përkatëse paguhet tarifa të ndryshme, për secilin paketë në tabelën e veçantë listohen informacionet nga pika 1) e këtij kapitulli.

24.13.5. Ofruesit e shërbimeve pagesore e fshijnë të gjithë tabelën, përfshirë edhe titullin *Paraqitje e detajuar të tarifave të përfshira në paketën e shërbimeve*, nëse paketa e shërbimit nuk ofrohet me llogarinë pagesore, ose nëse paketa e shërbimit që mundësohet me llogarinë pagesore paguhet si pjesë e tarifave për shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë pagesore.

24.13.6. Nëse numri i të gjithë shërbimeve në paketë nuk është i kufizuar ose sasi të shërbimeve që mbulohen nga paketa nuk janë tejkaluar, ofruesit e shërbimeve pagesore e fshijnë deklaratën në fund të tabelës që thotë *shërbimet që tejkalojnë këto sasi faturohen veçmas*.

24.14. Informacion shtesë

Në tabelën *Informacion shtesë* ofruesit e shërbimit pagesor i listojnë të gjitha informacionet shtesë të cilat janë të përshtatshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me pagesën e shërbimeve dhe tarifave, interesat e llogaritura ose të fituara ose me normat e interesit të zbatuara për të gjithë periudhën e mbuluar nga RT-ja. **Në këtë tabelë ofruesit e shërbimeve pagesore listojnë shumën e tarifave dhe interesave të papaguara në një datë të caktuar, por vetëm për atë që është llogaritur në periudhën kalendrike në të cilën është përpunuar RT-ja.** Ofruesit e shërbimit pagesor në Informacionet shtesë listojnë çfarëdo qoftë informacioni shtesë nga ato të mbuluar në pikat 1), 2), 3), 4), 5), 6), 7), 8), 9), 10), 11), 12), 13), 14), dhe 15) të këtij kapitulli, të cilët drejtpërdrejt janë të lidhura me shërbimet

dhe tarifat pagesore, interesat e përlogaritura ose të përfituara, ose normën e interesit të zbatuar për periudhën që mbulon RT-ja. Ofruesi i shërbimeve pagesore e fshin tabelën *Informacion shtesë* nëse në të nuk liston asnjë nga informacionet në fjalë.

24.15 Markat tregtare

Nëse përdoret markë tregtare, shënohet në kllapa katrore menjëherë pas përfundimit të termit në fontin e parashikuar në nënpikën (6), pika 20) të kreut V të këtij udhëzimi.

VII. PËRDORIMI I MJETEVE ELEKTRONIKE

25. Nëse DIT-i, respektivisht RT-ja përgatitet dhe dorëzohet në mënyrë elektronike, ofruesit e shërbimeve pagesore mund të ndryshojnë formularin DIT, respektivisht RT vetëm në mënyrën e përcaktuar me këtë pikë, me kusht që konsumatori njëkohësisht të pranojë kopje të RT-së në pajtueshmëri me propozimin e përcaktuar në shtojcën 2 të vendimit dhe të plotësuar siç është e paraparë në dispozitat nga kreu VI i këtij udhëzimi:

- Nëse dimensionet e mjeteve elektronike, gjatë përdorimit të tabelave dhe kolonave të ndryshme e vështirësojnë leximin e DIT-së ose RT-së, mund të përdoret vetëm një kolonë ose një tabelë, me kusht që të mbetet renditja e informacionit, titujve dhe nëntitujve;
- Nëse përdoren mjete elektronike si shtresat (*ang. Layer*) dhe dritaret *pop-up* (*angl. pop-up window*), ofruesit e shërbimeve pagesore detyrimisht duhet të shfaqin në mënyrë të dukshme titullin e DIT-së, respektivisht RT-së, simbolin e përbashkët, deklaratat hyrëse, titujt dhe nëntitujt, dhe ruhet renditja e informacioneve.
- Me përdorimin e aparateve elektronike nga nënparagrafi (2), paragrafi (1) të kësaj pike, ofruesit e shërbimit pagesor nuk guxojnë ta shpërqendrojnë konsumatorin nga informatat e DIT-së respektivisht RT-së përderisa shtresat dhe dritaret *pop-up* mund të përmbajnë vetëm informacionet nga ky udhëzim.

VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

26. Ky udhëzim hyn në fuqi në ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

U. nr. 02-1710/1
18.01.2023
Shkup

Guvernatorja
д-р Анита Ангеловска-Бежоска

S H T O J C A 1

Shembulli nr. 1

Shërbimi	Tarifa						
Shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë pagesore							
Mirëmbajtja e llogarisë pagesore [markë tregtare]	Tarifa mujore: 10,00 MKD Tarifa e përgjithshme vjetore: 120,00 MKD						
Llogari e pensionistëve							
Tarifa mujore:	5,00 MKD						
Tarifa e përgjithshme vjetore:	60,00 MKD						
Përdorimi i shërbimeve onlajn që lidhen me llogari pagesore	Shfrytëzimi i internetit [markë tregtare] Tarifa mujore: 10,00 MKD Gjithsej e përgjithshme vjetore: 120,00 MKD						
	Shfrytëzimi i aplikacionit celular [marka tregtare] Tarifë mujore: 8,00 MKD Tarifa e përgjithshme vjetore: 96,00 MKD						
Pagesa (përveç me kartela)							
Transferimi i kredisë në denarë në vend	Pagesë në dobi të llogarisë të personave fizik tek ofruesi i shërbimit pagesor pa tarifë						
	Pagesë në dobi të llogarisë persona juridik tek ofruesi i shërbimit pagesor <table> <tr> <td>sportel</td> <td>5,00 MKD</td> </tr> <tr> <td>internet</td> <td>1,00 MKD</td> </tr> <tr> <td>aplikacioni celular</td> <td>2,00 MKD</td> </tr> </table>	sportel	5,00 MKD	internet	1,00 MKD	aplikacioni celular	2,00 MKD
sportel	5,00 MKD						
internet	1,00 MKD						
aplikacioni celular	2,00 MKD						
	Pagesë në dobi të llogarisë tek ofrues tjetër i shërbimit pagesor <table> <tr> <td>sportel</td> <td>10,00 MKD</td> </tr> <tr> <td>internet</td> <td>2,00 MKD</td> </tr> <tr> <td>aplikacioni celular</td> <td>10,00 MKD</td> </tr> </table>	sportel	10,00 MKD	internet	2,00 MKD	aplikacioni celular	10,00 MKD
sportel	10,00 MKD						
internet	2,00 MKD						
aplikacioni celular	10,00 MKD						
Transferimi i kredisë në euro jashtë vendit	Pagesat në euro jashtë vendit <table> <tr> <td>sportel</td> <td>100,00 MKD</td> </tr> <tr> <td>internet dhe aplikacioni celular</td> <td>0,20% e shumës</td> </tr> </table>	sportel	100,00 MKD	internet dhe aplikacioni celular	0,20% e shumës		
sportel	100,00 MKD						
internet dhe aplikacioni celular	0,20% e shumës						

Transferimi i kredisë në valutë të ndryshme nga euroja jashtë vendit	Shërbimi nuk është i disponueshëm		
	Përpunimi i urdhëresës nga jashtë	7,00 MKD	
	Marrëveshje e urdhërpagesës së përhershme	5,00 MKD	
Hyrje nga jashtë Urdhëresë përhershme	Realizimi i urdhëresës së përhershme në dobi të llogarisë tek ofruesi i shërbimit pagesor	pa tarifë	pa kompensim
Kartela dhe para të gatshme			
Lëshimi i kartelës së debitit	Regjistrimi	50,00 MKD	
	Anëtarësimi vjetor	100,00 MKD	
Lëshimi i kartelës së kreditit.	Regjistrimi	100,00 MKD	
	Anëtarësimi vjetor	100,00 MKD	
Tërheqje e parave të gatshme në sportel Tërheqje e parave të gatshme me kartelë debiti nga bankomati	Tërheqje e parave të gatshme paguar në sportel të ofruesit të shërbimit pagesor	5% e shumës së paguar shuma, min. 100 MKD	shuma
	Tërheqje e parave të gatshme në bankomat të ofruesit të shërbimit pagesor	pa tarifë	pa kompensim
	Tërheqje e parave të gatshme në bankomat tek ofrues tjetër e shërbimeve pagesore Në vend	2% e shumës së paguar shuma +7,00 MKD	shuma
	Tërheqje e parave të gatshme Në bankomat jashtë vendit	3% e shumës së paguar shuma + 15,00 MKD	

Tërheqje e parave të gatshme me kartelë krediti nga bankomati	Tërheqje e parave të gatshme në bankomat të ofruesit të shërbimit pagesor	3% + 20,00 MKD
	Tërheqje e parave të gatshme në bankomat tek ofrues tjetër të shërbimit pagesor në vend	2% + 7,00 MKD
	Tërheqje e parave të gatshme në bankomat jashtë vendit	3% + 15,00 MKD
Mbitërheqja e lejuar		
Mbitërheqja e lejuar	Norma vjetore e interesit	7,09% fikse

Shembulli nr. 2. Plotësimi i RK-së për llogarinë pagesore së konsumatorit që ofrohet si pjesë e paketës së shërbimeve të tjera që lidhen me llogarinë pagesore

Shërbimi	Tarifa
Shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë pagesore	
Mirëmbajtja e llogarisë pagesore (paketa 1.)	Tarifë mujore: 40,00 MKD Tarifa e përgjithshme vjetore: 480,00 MKD
Përfshin paketë të shërbimeve që përbëhet nga: - Mirëmbajtje të llogarisë pagesore në denarë - Interesi për mbitërheqjen e lejuar 8,10% - Mirëmbajtje të llogarisë pagesore në euro - Shërbimet e internetit [markë tregtare] - 10 transferta krediti pa para të gatshme (të inicuar nëpërmjet internetit ose urdhërpagesë të përhershme në dobi të një llogarie tek ofruesi i shërbimit pagesor) - Kartelë kreditit me pagesë të zgjatur - kartelë debiti - marrëveshje e urdhërpagesës së përhershme pa tarifë Shërbimet që tejkalojnë sasi të specifikuar faturohen veçmas Përdorimi i shërbimeve onlajn që lidhen me llogari pagesore	Shfrytëzimi i aplikacionit celular [markë tregtare] Tarifë mujore: 8,00 MKD Tarifa e përgjithshme vjetore: 96,00 MKD
Pagesa (përveç me kartela)	
Transferimi i kredisë në denarë në vend	Pagesë në dobi të llogaria e personave fizikë tek ofruesi i shërbimit pagesor Pagesë në dobi të llogarisë persona juridik tek

	ofruesi i shërbimit pagesor internet 1,00 MKD aplikacioni celular 2,00 MKD
	Pagesë në dobi të llogarisë tek ofrues tjetër të shërbimit pagesor internet 1,00 MKD aplikacioni celular 2,00 MKD
Transferimi i kredisë në euro jashtë vendit	Pagesat në euro jashtë vendit internet dhe celular 0,20% të shumës min. 25,00 MKD maks. 150,00 MKD
Transferimi i kredisë në valutë të ndryshme nga euroja jashtë vendit	Shërbimi nuk është i disponueshëm
Hyrje nga jashtë	
	Përpunimi i urdhëresës nga jashtë 7,00 MKD
Urdhëresë e përhershme	
	Realizimi i urdhëresës së përhershme në dobi të llogarisë tek ofruesi i shërbimit pagesor pa tarifë
	Realizimi i urdhëresës së përhershme në dobi të llogarisë tek tjetër ofrues i shërbimit pagesor 2,00 mkd
Kartela dhe para të gatshme	
Tërheqja e parave të gatshme në sportel	
Tërheqja e parave të gatshme me kartelë debiti nga bankomati	Tërheqje e parave të gatshme në bankomat të ofruesit të shërbimit pagesor pa tarifë
	Tërheqje e parave të gatshme në bankomat tek ofrues tjetër e shërbimeve pagesore në vend 2% nga shuma + 7,00 MKD

Tërheqja e parave të gatshme me kartelë krediti nga bankomati	Tërheqje e parave të gatshme në bankomat jashtë vendit	3% nga shuma e paguar +15,00 MKD
	Tërheqje e parave të gatshme në bankomat të ofruesit të shërbimit pagesor	3% + 20,00 MKD
	Tërheqje e parave të gatshme në bankomat tek ofrues tjetër të shërbimit pagesor në vend	2% + 7,00 MKD
	Tërheqje e parave të gatshme në bankomat jashtë vendit	3% + 15,00 MKD

Shembulli nr. 2. e paraqet paketën e cila së bashku me shërbimin *mirëmbajtje e llogarisë* ofron edhe shërbimin e lëshimit të kartelës së kreditit, marrëveshjen e urdhëresës së përhershme dhe shërbimin e mbitërheqjes. Në pajtim me këtë, ofruesi i shërbimit pagesor nuk është i detyruar përsëri t'i shkruajë këto shërbime dhe tarifa për ato në pjesën e poshtme të RK-së.

Nëse paketa e shërbimeve që lidhen me llogari pagesore i mbulon edhe të ashtuquajturat shërbime të internetit, por jo edhe të aplikacionit celular, ofruesi i shërbimit pagesor te shërbimi përdorimi i shërbimeve onlajn që lidhen me llogari pagesore në vazhdimësi të RK-së e liston vetëm tarifën e shërbimeve të aplikacionit celular (siç është në shembullin 2). Por, nëse paketa përfshin edhe internetin edhe aplikacionin celular, ofruesi i shërbimit pagesor e fshin të gjithë rreshtin e shërbimit të veçantë shfrytëzimi i shërbimeve onlajn që lidhen me llogari pagesore në RK-në, sepse kompensimi për atë shërbim është i mbuluar me tarifën e paketës së shërbimeve.

Shembull nr. 3. Shfaqje subline e tarifave dhe interesit

Shfaqje subline e tarifave dhe interesit

Gjithsej tarifa të paguara (gjithsej tarifa për paketën e shërbimeve dhe gjithsej tarifa të paguara)	MKD
Gjithsej interesi i paguar	MKD
Gjithsej interesi i fituar	interesat nuk zbatohen

Shembull nr. 4. Shembull i plotësimit të pjesës së RK-së *shërbimet e përgjithshme të lidhura me llogarinë.*

Shërbimi		Tarifa		
Shërbimi	Sa herë është përdorur shërbimi	Çmimi për njësi	Sa herë është tarifuar shërbimi	Gjithsej
Shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë				
Mirëmbajtja e llogarisë (paketa 1)	12	10,00 MKD	12	120,00 MKD
Shfrytëzimi i shërbimeve onlajn shfrytëzimi i shërbimeve të internetit [markë tregtare]	12	10,00 MKD	12	120,00 MKD
Shfrytëzimi i aplikacionit celular [marka tregtare]	12	9,00 MKD	12	108,00 MKD
Lëshimi i tokenit	1	0,00 MKD	Tarifa nuk është ngarkuar	0,00 MKD
Negocimi dhe përdorimi i llogarisë së pagesës në denarë nga personi i autorizuar	12	2,00 MKD	12	24,00 MKD

Shembull nr. 5. Shembull i plotësimit të pjesës së RK-së *raport i detajuar i interesit të paguar për llogari*

	Norma e interesit	Interesi
Interesi i rregullt për mbitërheqjen e lejuar 1.1.2020-31.3.2020 1.4.2020-31.12.2020	7,40% 7,07%	257,60 MKD 20,05 MKD
Interesi i paguar për paratë e gatshme të përdorura mbi mjetet personale ose mbi mjetet e autorizuar të mbitërheqjes 1.1.2020-30.6.2020 1.4.2020-31.12.2020	9,09% 9,05%	630,02 MKD 452,00 MKD
Gjithsej interesi i paguar		1.359,75 MKD

Shembull nr. 6. Shembull i plotësimit të pjesës së RK-së *raport i detajuar i interesit të fituar në llogarinë pagesore.*

	Norma e interesit	Interesi
Llogari pagesore në denarë - studentë 1.1.2020-31.3.2020 1.4.2020-31.12.2020	0,01% 0,10%	3,10 MKD 25,05 MKD
Gjithsej interesi i fituar		28,15 MKD

Shembulli nr. 7. Shfaqja e paketave të shërbimeve të ngarkuara si pjesë e Tarifave për shërbimin e mirëmbajtjes së llogarisë në kushtet e përgjithshme në lidhje me llogarinë

Shërbimi		Tarifa		
Shërbimi	Sa herë është përdorur shërbimi	Çmimi për njësi	Sa herë është tarifuar shërbimi	Gjithsej
Shërbime të përgjithshme të lidhura me llogarinë pagesore				
Mirëmbajtja e llogarisë (paketa 1) Përfshin paketë të shërbimeve që përbëhet nga: - mbajtjen e llogarisë pagesore në denarë - mbajtjen e llogarisë pagesore devizore - shfrytëzimi i shërbimeve të internetit - shfrytëzimi i shërbimeve të SMS-it - 10 urdhëresa pa para të gatshme për pagesë në denarë ose pagesë me urdhëresë të përhershme - 1 kartelë krediti sipas zgjidhjes Shërbimet që tejkalojnë sasinë e specifikuar tarifohen veçmas.	12	60,00 MKD	12	720,00 MKD
Shfrytëzimi i shërbimeve onlajn Shfrytëzimi i aplikacionit celular [markë tregtare]	12	9,00 MKD	12	108,00 MKD
Lëshimi i tokenit	1	0,00 MKD	Tarifa nuk është ngarkuar	0,00 MKD
Marrëveshja dhe përdorimi i llogarisë së pagesës në denarë nga personi i autorizuar	12	2,00 MKD	12	24,00 MKD